

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

07.12.2022
Ora, 11:06

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.
- **Parti Politike:** **PR (A. Madhi)**
- **Të tjerë:** **Përfaqësues nga KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë seancën publike të ditës së sotme, e cila ka në rend të ditës gjashtë çështje, të cilat janë në fakt, çështje të mbartura nga seanca publike e shkuar. Kemi:

Projektvendim “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Kemi në rend dite projektvendimin “Për edukimin, informimin, ndërgjegjësimin, si dhe krijimin e kushteve lehtësuese për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar”.

Projektvendimin “Për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë për zgjedhjet”.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Projektvendim “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të disa materialeve zgjedhore që përdoren nga administrata zgjedhore”, në procesin zgjedhor.

Kemi projektvendimin “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

Pika e gjashtë, projektudhëzim “Për mënyrën e komunikimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me bashkitë në kuadër të bashkërendimit të informacionit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Ky është akt i përgjithshëm dhe jo vetëm për 14 majin, apo jo?!

Atëhere, vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me programin e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, po drejtoreshë Ermina!

Znj. E. Allushi: Faleminderit Kryetar, programi për edukimin e zgjedhësve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, është një plan i cili përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve përgjatë periudhës zgjedhore.

Programi përmban tetë pjesë, janë të ndara në tetë objektiva kryesore si:


Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i zgjedhësve për datën e zgjedhjeve.

Informimi dhe ndërgjegjësimi i shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.

Ndërgjegjësimin e zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor, zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara.

Pjesa e katërt, ndërgjegjësimi i grupeve të ndryshme, votues për herë të parë, minoritetet, gratë, për rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Pjesa e pestë, ndërgjegjësimi i subjekteve zgjedhore mbi financimin e partive politike, të ardhurat që sigurojnë për fushatën zgjedhore.

Pjesa e gjashtë, informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet.

Pjesa e shtatë, informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit dhe mënyrën e votimit, hapat që ndiqen në qendrën e votimit.

Pjesa e fundit është informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj. Ky program i është dërguar dhe partive politike, organizatave të shoqërisë civile për konsultim. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka bërë disa sugjerime. Gjithashtu KRIIK ka bërë disa sugjerime, Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara. Të gjitha këto sugjerime, pjesa më e madhe e tyre janë marrë parasysh dhe janë paraqitur në program, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesit e partive politike? Nuk kanë ndonjë gjë! Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare? Nuk kemi!

Dakord, atëhere e miratojmë programin për edukimin e zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, sipas projektit të paraqitur nga Drejtoria e Komunikimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 220

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

07.12.2022
Ora, 11:09

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për edukimin, informimin, ndërgjegjësimin si dhe për krijimin e kushteve lehtësuese për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ:** **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
 Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.
- **Parti Politike:** **PR (A. Madhi)**
- **Të tjerë:** **Përfaqësues nga KRIIK**


Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Projektvendim “Për edukimin, informimin, ndërgjegjësimin, si dhe krijimin e kushteve lehtësuese për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi ndryshe”.

Znj. E. Allushi: Projektvendimi për edukimin, informimin, ndërgjegjësimin e personave me aftësi të kufizuara ka për qëllim të informojë dhe sensibilizojë zgjedhësit mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. Në mënyrë specifike programi ka si qëllim:

të informojë dhe edukojë zgjedhësit për datën e zgjedhjeve;
procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësit;
qendrën e votimit ku zgjedhësi voton;


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

procedurat e votimit dhe identifikimit elektronik;
plotësimi korrekt i fletës së votimit;
sensibilizimi i grupeve vulnerabël dhe të rinjve votues për herë të parë.
Objektivi kryesor i këtij programi është përveç edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të personave me aftësi të kufizuara, është informimi, ndërgjegjësimi i zgjedhësve për datën e zgjedhjeve. Informimi i shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit. Ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor. Ndërgjegjësimi i grupeve të ndryshme, votues për herë të parë, gratë, për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në votime. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit, mënyrën e votimit, hapat që ndiqen nga zgjedhësit në qendrën e votimit. Edukimi dhe informimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimi korrekt i saj. Informimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore mbi shkeljen dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor dhe parandalimi i tyre. Informimi dhe ndërgjegjësimi për të denoncuar shkeljet që konstatohen në lidhje me financimin e subjekteve zgjedhore dhe denoncimet e ndryshme. Mjetet e komunikimit që do të përdoren janë spotet televizive, mediat on-line, rrjetet sociale, materialet e ndryshme promocinale. Gjithashtu takimet me zgjedhësit dhe bashkëpunimi me organizata të ndryshme jo-qeveritare, që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu ky akt i është dërguar dhe partive politike, organizatave të shoqërisë civile për konsultim. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka bërë disa sugjerime dhe rekomandime për përfshirjen e tetë pjesëve të programit të edukimit të zgjedhësve për personat me aftësi ndryshe dhe janë reflektuar në akt, rekomandimet e sugjeruara. Gjithashtu dhe fondacioni “Së bashku” ka bërë disa sugjerime në funksion të përmirësimit të gjuhës së përdorur në program i cili është marrë po ashtu në konsideratë dhe është reflektuar, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit Ermina, përfaqësuesit e partive politike? Nuk kanë ndonjë diskutim! Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile? Nuk kanë ndonjë diskutim!

Mirë atëhere, e miratojmë programin e edukimin për këtë kategori zgjedhësish, duke menduar se vlen të thuhet që tashmë këtë aspekt të programit të edukimit, informimit të zgjedhësve dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve e kemi vendosur si te thuash ne pozita më normuese për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe e kemi bërë të domosdoshëm si aspekt për t'u përfshirë në vazhdim në të gjitha programet e KQZ-së për edukimin dhe informimin e zgjedhësve.

Vendimi nr. 221

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

07.12.2022
Ora, 11:13

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë për zgjedhjet”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike:** **PR (A. Madhi)**
- **Të tjerë:** **Përfaqësues nga KRIIK**


Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër! Po, Ermina!

Znj. E. Allushi: Projektvendimi për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, ka për qëllim të informojë dhe sensibilizojë zgjedhësit e këtij grupi, mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. Objektivat kryesore të projektvendimit janë:

Edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi i minoritetit grek në vend.

Edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi i minoritetit rom në vend, minoritetit egjiptian, minoritetit malazez, serb, maqedonas, boshnjak, arumun, bullgar. Pra të nëntë minoritetet që janë prezente në Shqipëri. Materiali që i dedikohet pakicave kombëtare që jetojnë në vendin tonë është i ndarë në nëntë pjesë, ku çdo pakicë kombëtare do të ketë mundësi për të marrë informacionin zgjedhor në gjuhën e tyre.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Çdo pjesë është e ndarë në disa nën ndarje, ku trajtohen temat gjithmonë si: edukimi, informimi, ndërgjegjësimi i zgjedhësve për datën e zgjedhjeve. Informimi mbi listën e zgjedhësit dhe qendrën e votimit. Ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor. Zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara. Ndërgjegjësimi i grupeve të ndryshme, votues për herë të parë, gratë, për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në votime. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit, identifikimi elektronik. Informimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore mbi shkeljen dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor. Informimi dhe ndërgjegjësimi për të denoncuar shkeljet që konstatohen gjatë procesit zgjedhor. Informimi i zgjedhësve mbi përmbajtjen e fletës së votimit, plotësimi korrekt i saj. Për të arritur në edukimin e pakicave kombëtare do të përdoren mjetet e ndryshme të komunikimit: spotet televizive, mediat on-line, rrjetet sociale, materialet e ndryshme promocinale, takimet me zgjedhësit e pakicave kombëtare. Ky projektvendim i është dërguar partive politike, organizatave të shoqërisë civile për konsultim. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka bërë disa sugjerime mbi përmirësimin, gjithmonë të tekstit dhe programit të ndërgjegjësimit të pakicave kombëtare, të cilat janë marrë parasysht dhe janë reflektuar. Theksoj faktin që i janë dërguar të gjitha ambasadave që janë prezente në Shqipëri dhe që kanë përfaqësi minoriteti në Shqipëri dhe nuk kanë pas asnjë sugjerim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Edhe ky është nja akt shumë i rëndësishëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi e normon në mënyrë përfundimtare dhe këtë aspekt të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve dhe është tregues i ndërgjegjësimit jo vetëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por në përgjithësi të shtetit shqiptar për kujdesin dhe vëmendjen ndaj pakicave kombëtare në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Republikën e Shqipërisë. Mirë, miratojmë dhe këtë program sipas draftit të paraqitur, duke qenë se kemi konsideruar pothuajse të gjitha mendimet dhe pikëpamjet qoftë të partive politike, por dhe organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit përfshirë këtu më tej dhe institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat përfaqësojnë këtë kategori.

Vendimi nr. 222

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

07.12.2022
Ora, 11:17

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike:** **PR (A. Madhi)**
- **Të tjerë:** **Përfaqësues nga KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, me projektvendimin “Për miratimin e modelit dhe specifikimin e disa materialeve zgjedhore që përdoren nga administrata zgjedhore në zgjedhje!

Z. Y. Merkaj: Neni 99 i Kodit Zgjedhor, parashikon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve materialet e mëposhtëme zgjedhore, të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi, ndër të cilat janë: vulat me kod sigurie që shërbejnë për vulosjen e të gjitha kutive të votimit dhe të materialeve zgjedhore, kutitë e votimit, kutitë e materialeve zgjedhore, lëndën e posaçme për timbrimin e zgjedhësve si dhe dhomën e fshehtë. Bashkëlidhur, administrata ka parashikuar dhe ka detajuar specifikimet e përgjithshme teknike të këtyre materialeve. Gjithashtu Komisioneri Shtetëror i

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Zgjedhjeve në bazë të nenit 19 të Kodit Zgjedhor, urdhëron përdorimin e këtyre mjeteve dhe materialeve të përshkruara në Lidhjen nr. 1 të këtij projektvendimi. Gjithashtu, përcaktimi i sasive të materialeve, kritereve dhe specifikimeve teknike të tjera veçmas dhe të atyre qëpërmban Lidhja nr. 1, do të bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit për prokurimet publike. Ngarkohet gjithashtu administrata e KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike? Nuk kemi diskutime! Mirë atëhere, e miratojmë dhe këtë projektvendim sipas draftit të paraqitur.

Vendimi nr. 223

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

07.12.2022
Ora, 11:19

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2. Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.

• **Parti Politike:**

PR (A. Madhi)

• **Të tjerë:**

Përfaqësues nga KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e gjetjeve të raportit mbi financimin e partive politike dhe subjekteve zgjedhore dhe shpenzimet për zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Fjala për drejtoreshë Valbonën!

Znj. V. Ballgjini: Faleminderit Komisioner! Në fakt ky është një vendim i mbartuar prej disa mbledhjesh. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar detyrimeve që ka për të verifikuar të ardhurat dhe shpenzimet e partive politike gjatë fushatës zgjedhore, ka bërë verifikimet përkatëse lidhur me fazën e parë, pas dorëzimit të raporteve të auditimit nga audituesit ligjorë. Kemi pas një shtyrje të një seance lidhur me pretendimet e ngritura nga disa subjekte zgjedhore për të sjellë materiale shtesë. Më pas kemi dhe një shtyrje të tretë, lidhur me konstatimet, informacion shtesë që


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

ka sjellë KRIIK lidhur me zyrat zgjedhore, me shpenzimet e fushatës zgjedhore nga kandidatë, apo subjekte politike në rrjetet sociale. Nga gjithë, le të themi monitorimi i kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga verifikimet e kryera pas administrimit të raporteve, kemi mospërputhje lidhur me tejkalimin e kufirit të limitit të shpenzimeve për parti politike. Deklarimin e raporteve financiare sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja. Ka mospërputhje lidhur me mosdorëzimin e raporteve financiare nga kandidatë të listave shumemërore. Mungesë të dokumentave justifikuese mbi shpenzimet e kryera gjatë fushatës zgjedhore nga dy subjekte zgjedhore. Gjithashtu është vënë re që disa parti politike nuk kanë shpenzuar të gjithë fondin e vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe janë të detyruara të kthejnë diferencën. Është vënë re një problem lidhur me mosbashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si nga ana e subjekteve zgjedhore, ashtu dhe nga personat e tretë të cilëve u është kërkuar informacion nga ana jonë. Këto janë lidhur me partitë politike. Janë vënë re mospërputhje me reklamat në mediat audiovizive. Kemi tejkalim të 90 minutave, kohës së lejuar për reklama politike në OSHMA-të. Tejkalim të 45 minutave të kohës falas që i vihet në dispozicion subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës zgjedhore. Kemi mosdorëzim të tarifave zyrtare nga ana e OSHMA-ve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu siç e thashë edhe më lart, ka disa OSHMA, të cilat nuk kanë kthyer përgjigje. Në këtë rast nuk kemi bërë të mundur bashkëpunimin me to. Pika e fundit që doja të sillja në vëmendje, pas shtyrjes së vendimit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e zhvilluar në datën 3 nëntor 2022, KRIIK nëpërmjet e-mail-it dërgoi konstatimet e bëra për 19 subjekte zgjedhore, ku të gjithave ju dërgua nga një e-mail me të gjitha konstatimet e vërejtura nga KRIIK. Nga 19 subjekte zgjedhore sollën përgjigje 13. Për 2 subjekte zgjedhore u bë e pamundur komunikimi me to dhe 4 subjekte zgjedhore nuk kthyen përgjigje. Nga çfarë u konstatua lidhur me përgjigjet e kthyera

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

nga vetë subjektet zgjedhore, informacioni që ne vetë kishim administruar dhe atë çfarë KRIIK dorëzoi, u vu re.., për sa u përket zyrave zgjedhore, doja të theksoja këtu se tipologjia e informacionit që KRIIK ka përcjellë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ka nevojë të vlerësohet apo verifikohet në kohë reale gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore. Në këtë fazë ishte i pamundur verifikimi i saktë në terren për të konstatuar informacionin, për shkak se partitë politike pretendojnë tjetër numër të zyrave zgjedhore që ata kanë pas në terren. Partitë politike pretendojnë se numrin e saktë për zyrat zgjedhore të paguara, apo të dhuruara nga ato e kanë paraqitur në raportet e tyre financiare dhe nuk kanë pas zyra të tjera përveç atyre të deklaruara në raportet e tyre. Lidhur me dorëzimin e bilancit të aseteve, kjo është vënë re edhe në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pas dorëzimit të raporteve financiare nga vetë subjektet zgjedhore. Ju është dërguar një shkresë që herët subjekteve zgjedhore dhe na kanë vënë në dispozicion bilancin e aseteve, duke theksuar që për periudhën zgjedhore nuk kanë pas ndryshime në bilancin e aseteve. Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të Partisë Lëvizja e Re, për reklama politike në rrjetet sociale facebook dhe instagram, rezulton se tre kandidatë nuk i kanë deklaruar këto shpenzime. Gjithashtu rezulton se kandidati i Lëvizjes së Re ka pranuar dhurime mbi vlerën e lejuar, ka pranuar dhurime “kesh”, pra para në dorë mbi vlerën e lejuar, pra jo nëpërmjet llogarive bankare. Për reklamën politike në facebook dhe instagram, gjithashtu ka shpenzime për një nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, i cili nuk e ka sjellë si informacion në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Së fundmi, doja të theksoja që kemi vënë re një problematikë lidhur me financierët e partive politike, ku rezulton që katër financierë të subjekteve të ndryshme politike kanë qenë kandidatë të listave shumemërore të subjekteve të ndryshme politike. Kanë qenë kandidatë edhe të listave shumemërore të secilit subjekt. Këto janë konstatimet nga çfarë KRIIK solli dhe çfarë ne morëm në konsideratë ne si KQZ. Për më tepër të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

gjitha këto janë të detajuara në raportin e gjetjeve të punuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.


Z. I. Celibashi: Një pyetje, para se t'i japim fjalën përfaqësuesve të partive, në raport janë të përfshira të gjitha këto si gjetje?

Znj. V. Ballgjini: Po Komisioner, janë të gjitha, referuar edhe me çfarë ne kemi vënë re si shkelje. Referuar edhe se kujt i koorespondojnë me Kodin Zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Atëhere përfaqësues të partive politike, diskutime? Po zoti Arjan Madhi, fjala për ju!

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: I nderuar zoti Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve, është e vërtetë që administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka bërë një punë të lavdërueshme për sa i takon eksigjencës së saj lidhur me trajtimin e gjetjeve, duke ju referuar gjithmonë dispozitave ligjore mbi sanksionimin e tyre të parashikuar nga Kodi Zgjedhor. Ndërkohë, ju na keni dhënë mundësinë që disa herë rradhazi, duke qenë se e keni shtyrë disa herë proceduralisht mbledhjen për shkak të nevojave të subjekteve zgjedhore për të paraqitur pretendimet e tyre për të pas më shumë kohë, ju ua dhatë këtë mundësi. Fatmirësisht gjatë disa seancave të mbledhjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kemi parashtruar dhe ato ç'ka ne kemi konstatuar në mënyrë të rëndësishme për të tërhequr vëmendjen tuaj si Komisioner. Së pari kemi thënë që kjo ka qenë një eksperiencë e parë në praktikën tonë se si do të operohej për sa i takon problemit se si do të paraqitej raporti sipas rregullave të parashikuar nga Kodi Zgjedhor. Së dyti, ne mendonim se duhej të konsiderohej nga Komisioneri edhe vullneti i subjekteve në mënyrë që të nxiteshin këto për një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

qëndrim sa më korrekt, për sa i takon zbatimin të Kodit Zgjedhor. Së treti, konfuzioni që ishte krijuar në ligj për shkak të jo keqkuptimit po për shkak të trajtimit gati-gati të paqartë ishte fakti se kush do të ishte përgjegjës për sa i takon përgatitjeve së deklarimeve sipas formatit të standartizuar. Kjo për shkak se subjekti zgjedhor, në kuptimin tonë mban përgjegjësi për vënien në dijeni të çdo kandidati për detyrimin që ka, sepse deklarimi bëhet personalisht nga kandidati. Asnjë subjekt zgjedhor nuk është i mundur të ketë një mënyrë të tillë komunikimi që të jetë i njohur me të gjitha shpenzimet. Pra, është përgjegjësia e tij. Në fund pasi ju na dhatë mundësinë e disa seancave rradhazi, unë po marr rastin e Partisë Republikane, e cila që në gjetjet e para është konstatuar në tre raportime që ka bërë, që nuk ka qenë brenda formatit të standartizuar. Pasi ne na u dha mundësia, dy nga këto, u justifikuan me dokumentacionin përkatës pranë administratës tuaj. Një person i vetëm, kandidat, mbeti ende i paqartë për shkak të mosdeklarimit të tij. Ne u pozicionuam pranë në seancat e komunikimit me administratën, se sa është e vërtetë kjo rrethanë. Rrethana na rezultoi kështu: të provuar pranë punonjësve të administratës tuaj. Ne kemi të dokumentuar faktin që kemi komunikuar me kandidatin. Kandidati ka nënshkruar marrje në dijeni, për detyrimin për të plotësuar deklarin e tij. Ka marrë dijeni dhe ka nënshkruar dhe përgjegjësinë që ka për mosdeklarim dhe pas kësaj kandidati nuk e ka realizuar përfundimisht dorëzimin e këtij dokumenti. Për të mos u zgjatur shumë po ju them se ajo që unë konstatoj, me keqardhje po ju them dhe po këmbëngul për herë të dytë është fakti që dispozita e Kodit Zgjedhor neni 173, pika 3, parashikon një marzh dënimi nga 500 mijë deri në 1 milion lekë të reja. Nga ana tjetër kjo nuk është zbatuar në propozimin që trajoni ju në mënyrë të arësyeshme dhe korrekte. Për sa kemi një marzh do të thotë që duhet të kemi ca kritere se si zbatohet ky marzh. Në se administrata raporton dhe ju kërkon ju për një parti e cila nuk ka plotësuar 152 kandidatë, pra për të gjithë listën nuk është deklaruar, propozojnë për t'u sanksionuar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

me 500 mijë lekë. Për një parti që ka vetëm një kandidat, pra e ka shpreh vullnetin, ka qenë e gatshme të bashkëpunojë, i ka kryer të gjitha detyrat, ju jepni sanksione për 500 mijë lekë. Vallë ky është vetëm një rast? Jo nuk është një rast! Kemi parti të mëdha politike të cilat nuk kanë deklaruar deri në 70 kandidatë të tyre, pra gjysmën e listës së tyre dhe përsëri ato marrin 500 mijë. Në këtë kuptim do të thoja, do të sillja në vëmendjen tuaj, së pari, e kam kërkesë para jush. Të verifikohet nëse subjekti Partia Republikane e ka përmbush detyrimin me kandidatin, të dokumentuar që është njoftuar dhe kandidati nuk ka pas dëshirë ta sjellë deklaratën? Këtë do të doja të sillja në vëmendjen tuaj për të marrë masën. Së dyti, a duhet ta konsideroni sot dhe në të ardhmen faktin që përderisa legjislatori ka parashikuar një marzh dënimi, ky të ketë një kriter. Të mos jetë thjesht vullneti i një njeriu që thotë “këtij do t’i jap 500 mijë lekë”, pavarësisht se ai subjekt e ka shkelur disafish në raport me subjektin tjetër. Në këtë kuptim do t’u thoja që duhet rishikuar fakti i masës së gjobës qoftë dhe për një njeri. Në përfundim, rastin që unë do t’ua bëj dhe një herë me dije që e kam të provuar që ky kandidat ka nënshkruar deklaratën, ka marrë dijëni dhe nuk ka dëshiruar të raportojë, kjo është çështje që duhet zgjidhur me ligjin. Çfarë bëhet dhe kush ndëshkohet në këtë rast! Subjekti që ka detyrimin për të informuar, apo subjekti që ka detyrimin për të deklaruar? Kërkoj mirëkuptimin tuaj!

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Madhi! Ashtu sikurse ju e thatë kjo ka qenë një eksperiencë e parë, si për partitë politike, subjektet zgjedhore, po ashtu dhe për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Eksperiencë e parë në kuptim të asaj se çfarë rishtazi detyrimet e Kodit Zgjedhor kanë implikuar detyrime si për partitë politike, po ashtu dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Pikërisht për këtë arsye, ky proces ka marrë kohë tej pritshmërive të gjithësecilit prej nesh të përfshirë në këtë proces. Sikurse e kemi thënë dhe herë të tjera, në se ka një pjesë të Kodit Zgjedhor e cila do


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

të duhet në mënyrë rrënjësore të ndryshojë është pjesa që ka të bëjë me rregullat që lidhen me financimin. Pa i hyrë mënyrës, sistemit se si do të financohen, apo se si do të bëhet ky kontroll. Qoftë dhe për faktin, në vlerësimin tonë dhe ky vlerësim tashmë është i konsoliduar si opinion për ne si KQZ, të lidhur me mospërputhjet, inkoherencën në raport të shkeljeve me sanksionet, etj. si këto. Për të mos thënë që ka dhe formulime të cilat personalisht do t'i vlerësoja edhe të pakuptueshme në ndonjë rast. Ka qenë e vështirë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më së pari për administratën e KQZ-së, që të analizonin gjithë informacionin e marrë nga partitë politike, i cili ka qenë voluminoz. Të ballafaqonte këtë informacion me atë çfarë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë si rrjedhojë e rezultatit të procesit të auditimit, apo dhe me gjetjet nga organizatat e ndryshme të shoqërisë civile. Kështu që vërtet ka qenë një proces, qoftë dhe në pikëpamje të administrimit formal të tij, është dashur që të marrë shumë kohë. Për të mos thënë pastaj që ka pas vështirësi në lidhje me interpretimet që ne do të duhej t'i bënim Kodit Zgjedhor, por edhe gjetjeve. Lidhur me këtë raportin kandidat - parti politike që ka propozuar këta kandidatë dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kur ka qenë e vështirë për ju si parti politike që ta administroni këtë raport me kandidatët tuaj, mendo se sa e vështirë ka qenë, do të ishte dhe do të jetë dhe në të ardhmen besoj, për institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithësesi, kjo është një çështje që i takon ligjvënësit. Në vlerësimin dhe interpretimin tonë, raporti ndërmjet kandidatëve dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për sa i përket financimeve që ata marrin dhe shpenzimeve që ata bëjnë, kalon nëpërmjet partive politike. Ndoshta për zgjedhjet e ardhshme, ne do të duhet, në qoftë se Kodi Zgjedhor nuk do të ndryshojë në këtë aspekt dhe me sa duket jo, ne si KQZ do ta sjellim në vëmendjen tuaj si parti politike këtë moment. Për t'ju bërë të ditur që të ndërtoni një raport të tillë me kandidatët tuaj që të mos gjendeni në pozitën që të gjitha përgjegjësitë që ata duhet të përmbushin nuk i kanë përmbushur

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

dhe sanksionet t'i ngarkohen vetëm partisë politike. Gjithësesi besoj do të kemi kohë për këtë. Mendoj që në tërësi ky raport, e them pa hezitim dhe pa droje, i ka trajtuar në mënyrë korrekte dhe të ndershme të gjitha problematikat që lidhen me financimin e partive politike dhe kandidatëve për zgjedhjet e 25 prillit 2021, për aq sa është e mundur kjo në përputhje me parashikimet e kodit. Mendoj që gjithësecili prej nesh do të donte që të kishte më shumë transparencë, por kjo lidhet drejtë për drejtë me krijimin e më shumë mekanizmave për të verifikuar, të cilat, të gjithë jemi koshientë, që as Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por as ndonjë institucion tjetër nuk i disponon. Pra, me pak fjalë për aq sa ligji ka parashikuar dhe për aq sa ka qenë e mundur, mendoj se trajtimi që ka bërë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. E çfarë është më e rëndësishme? Këto gjetje dhe këto sanksione që ne propozojmë në vazhdim, reflektojnë interesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ta administruar këtë aspekt të procesit zgjedhor ashtu si do të dojë të administrohet dhe pa pasur asnjë lloj interesi politik dhe asnjë lloj droje nga askush. Edhe pse mendoj se për dikë kjo mund të duket thjesht një retorikë por e vërteta kjo është. Atëhere, bazuar në këto gjetje të këtij raporti vendos:


E para, miratimin e gjetjeve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes që do t'i bashkëlidhet këtij vendimi.

T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve:

Marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Demokratike" me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 8.

Marrjen e masës administrative, për financierin e partisë politike "Partia Demokristiane e Shqipërisë" me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Marrjen e masës administrative, për financierin e partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për kandidatin zotin Fitimtar Lala të partisë politike “Partia Lëvizja e Re” me gjobë në masën 195 000 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Lëvizja e Legalitetit” me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë” me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Republikane” me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.


Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Balli Kombëtar Demokrat” me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar” me gjobë në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Nisma Thurje” me gjobë në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Bindja Demokratike” me gjobë në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare” me gjobë në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Socialdemokrate” me gjobë në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Balli Kombëtar” me gjobë në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Demokratike” me gjobë në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3, pra janë për shkelje të tjera këto.


Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milion) lekë, sipas nenit 173, pika 9 të Kodit Zgjedhor.

Detyrimin e partisë politike “Partia Socialdemokrate” të kthejë në KQZ shumën prej 1.629.360 (një milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë, sipas nenit, 88 pika 7 të Kodit Zgjedhor. Pasi ka marrë para nga buxheti i shtetit dhe nuk i ka shpenzuar, të paktën sipas deklarimit të vetë partisë.

Detyrimin e partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” të kthejë në KQZ shumën prej 55.166,74 (pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e katër) lekë, sipas nenit, 88 pika 7 të Kodit Zgjedhor, pra njësoj si rasti i Partisë Socialdemokrate.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Detyrimin e partisë politike “Fryma e Re Demokratike” të kthejë në KQZ shumën prej 485.332 (katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë, sipas nenit, 88 pika 7 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës nga Komisioneri Shtetëror, masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv ADTN, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Digitalb TV, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin ABEG Tv, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin BBF, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Club Tv, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Era Digitalb, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Glob Tv, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin One Tv Vlora, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Syri Tv, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv, pra për operatorin Shijak Tv sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv BS sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv 6+1 Vlora sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Alpo sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Antena Nord sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Apollon sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Berati sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Channel 1 sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Channel 7 sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor .


Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Jug sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për Ofruesin e Shërbimit operatorin Tv Klaudiana sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Kopliku sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

43. Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Kukësi sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Lobi sipas neneve 84, pika 5 dhe 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Mati i sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Premium Channel i sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Rozafa Motiv sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë dhe për operatorin Tv Saranda sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Masë administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Scan sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Sot 7 po sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Star Plus po sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.


Masë administrative me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv UTV Education sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Masë administrative me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin TVT sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Masë administrative me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për operatorin Tv Re. Al sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Sanksion administrativ me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin One TV Ora, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Masë administrative me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin Report TV, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Masë administrative me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin Klan News, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Masë administrative me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin Shijak TV, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Masë administrative me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin Tv 6+1 Vlora, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Këto sanksione lidhen kryesisht me tejkalim të 90 minutëshit dhe 45 minutëshit nga operatorët.

Vendosjen e masës administrative me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin A2 CNN, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e masës administrative me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin Syri TV, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e masës administrative me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin Euronews Albania, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor .


Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin Fax News, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin Klan TV, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin News 24, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

për operatorin Vizion Plus, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin Top News, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin Abc News, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin TV1 Channel, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin TV RE-AL, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.


Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin RTV Ora, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për operatorin Top Channel, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin One TV Vlora, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin Klan Plus, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve për operatorin TV Best, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në masën e 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekëve për operatorin Top Channel, sipas neneve 84, pika 6 në këtë rast dhe neni 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekëve për operatorin Abc News, sipas neneve 84, pika 6, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë për operatorin Top Channel, në këtë rast, sipas neneve 92/6, pika 6 dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën e 100 000 (njëqind mijë) lekë për operatorin Top News, sipas neneve 92/6, pika 6 dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë për operatorin Vizion Plus, sipas neneve 92/6, pika 6 dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

Vendosjen e masës administrative me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për operatorin TV Ora, sipas neneve 92/6, pika 6 dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

Marrjen e masës, pra vendosjen e sanksionit administrativ në vlerën e 100 000 (njëqind mijë) lekëve për operatorin News 24, sipas neneve 92/6, pika 6 dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e shpalljes së tij, faleminderit!

Vendimi nr. 224

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

07.12.2022
Ora, 11:32

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për mënyrën e komunikimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me bashkitë në kuadër të bashkërendimit të informacionit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike:** **PR (A. Madhi)**
- **Të tjerë:** **Përfaqësues nga KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me projektaktin për disiplinimin e raportit të marrëdhënieve ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe bashkive. Po, Erjoni!

Z. E. Meta: Projektudhëzimi i paraqitur për miratim ka për qëllim të lehtësojë mënyrën e komunikimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me bashkitë në kuadër të bashkërendimit të informacionit për procesin zgjedhor. Nga shpallja e dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve, kryetarët e bashkive për qëllim të bashkërendimit të informacioneve me KQZ-në, të caktojnë një person përgjegjës i cili raporton për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Në këtë projektudhëzim përcaktohet mënyra dhe kanalet e komunikimit të personit përgjegjës me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Personi i ngarkuar nga kryetari i bashkisë për komunikimin me KQZ-në, refron informacion lidhur me ambjentet zgjedhore, ambjentet për organizimin e trajnimeve, dërgimin e hartës së njësisë të qeveisjes vendore, ecurinë e procesit të njoftimit të zgjedhësve, si dhe çdo informacion që lidhet me procesin zgjedhor. Projektudhëzimi është dërguar për mendim partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilat nuk kanë shprehur komente. KRIIK, ose Koalicioni për Reformë Integrim dhe Instuticione të Konsoliduara ka sugjeruar disa rekomandime në funksion të përmirësimit të udhëzimit. Sugjerimi i parë, KRIIK sugjeron që ky mekanizëm komunikimi nevojitet të konsiderohet edhe në funksion të identifikimit të masës së mënyrës së ligjzbatueshmërisë, pra aktorëve të tretë në raport me detyrimet e tyre ligjore për të informuar bashkitë, lidhur me zyrat zgjedhore, apo elementë të tjerë që lidhen me fushatën, financimin, apo përdorimin e burimeve shtetërore. Në lidhje me këtë sugjerim, shprehemi parimisht dakord dhe sqarojmë se këto pika kontakti të vendosin në funksion të bashkërendimit të KQZ-së për detyrat që vetë Kodi Zgjedhor i ka vendosur bashkive. Për sa i përket detyrimeve të tjera që bashkitë kanë në cilësinë e instuticioneve publike që raportojnë në ndërfaqen e raportimeve të dedikuara veprimtarive me karakter publik që bashkitë zhvillojnë, tashmë KQZ u ka kërkuar të gjitha instuticioneve publike, përfshirë bashkitë caktimin e një personi kontakti. Ky person kontakti do të jetë përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për çdo komunikim tjetër në kuadër të zhvillimit të proceseve parazgjedhore dhe zgjedhore, përfshirë trajtimin e hetimit administrativ rast pas rasti. Një sugjerim tjetër nga KRIIK është që të parashikohet në të njejtin akt plotësimi i pikës 1, detyrimet specifike dhe ndërlidhja me instuticionin e prefektit. Referuar rolit specifik që jepet nga ligji për çdo eventualitet që mund të sjellë ecuria e procesit në vijimësi. Sqarojmë se ky udhëzim është menduar dhe dedikuar vetëm për bashkëpunime me bashkitë. Është vlerësuar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.12.2022*

si i rëndësishëm vendosja e një komunikimi operativ me bashkitë, pasi ato kanë një peshë të konsiderueshme detyrash dhe detyrimesh që burojnë nga Kodi Zgjedhor. Për sa i përket detyrave që kodi i ngarkon prefektit, që janë shumë të kufizuara dhe mund të menaxhohen edhe nëpërmjet komunikimit shkresor. Sugjerimit të KRIIK për riformulimin e pikës 3 janë marrë përgjithësisht në konsideratë dhe janë reflektuar duke u detajuar në këtë pikë. Gjithashtu është reflektuar edhe sugjerimi për marrjen e masave administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike? Nuk kemi diskutime! Mirë atëhere, miratojmë dhe këtë projektakt sipas draftit të propozuar. Çështje të tjera nuk kemi në rendin e ditës. Mirë, faleminderit, seanca mbyllet!

Udhëzimi nr. 4

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

